



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.154/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa ZL.Anr.154/2017 e datës 09.10.2017 e parashtruar nga Instituti për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Podujevë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 09.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati Ajet Potera për kryetar të Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik LVV, pretendohet se me dt.09.10.2017, rreth orës 15:58, ka postuar foto në faqen e tij të Facebook-ut, duke përfshirë fëmijë, sepse postimi ka përmbajtje politike që ndërlihdhet me fushatën zgjedhore.

Me këtë rast, parashtruesi i ankesës ka theksuar se është shkelur rregulla zgjedhore 13/2013 neni 5.2 duke përfshirë fëmijë në fushatë zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të datës 10.10.2017, theksoj se menjëherë pasi që ka pranuar urdhrin nga PZAP-i ka ndërmarr masat përmirësuese lidhur me këtë çështje dhe ka larguar fotografën e publikuar në Facebook, duke shtuar se ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e saj për dispozitat e Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nevojën për të zbatuar dispozitat e tij. Andaj subjekti politik LVV ka ndërmarr të gjitha masat për të evituar shkeljet e mundshme nga anëtarët, mbështetësit apo kandidatët për zgjedhjet lokale.

Gjithashtu, subjekti politik LVV ka theksuar se fotoja është bërë gjatë rrugës pas insistimit të një kalimtari që fëmija i tij të bëjë foto me Albin Kurtin dhe kandidatin për kryetar të komunës së Podujevës Ajet Potera dhe se nga fotoja shihet një fëmijë e jo i mitur ashtu siq theksohet në ankesë.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur një fotografi ku shihet se është larguar fotografia nga rrjeti social Facebook.

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e organizatës BIRN, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 5.2 i Rregulles Zgjedhore nr.13/2013 i KQZ-së, për arsye se kandidati për kryetar të komunës së Podujevës Ajet Potra nga radhët e subjektit politik LVV nuk ka bërë fushatë me të mitur, pasi që i njëjti ka qenë duke kaluar rrugës dhe po ashtu nuk vërtetohet me asnjë provë se ka pasur tubim publik, lidhur me rastin në fjalë.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.154/2017 më datën 12.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.